

ENKELEIDA KAPIA, ANILA KANANAJ

TOPIKA E PËRCAKTORËVE TË NJËPASNJËSHËM TË NJË EMRI NË SHQIPEN E SOTME

1. Hyrje

Topika e përcaktorëve të njëpasnjëshëm përbën padyshim një çështje me interes të veçantë, e cila është hulumtuar nga disa albanologë shqiptarë. Studimet e deritanishme sintaksore janë përqendruar në dy aspekte kryesore: a) në analizën dhe shpjegimin e modeleve të renditjes së dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një emri që ka shqipja dhe b) në përshkrimin e këtyre modeleve duke marrë parasysh të dhëna vetëm nga shqipja letrare. Ky artikull synon të hedhë dritë në dy drejtime të rëndësishme: a) të hartojë një paradigme sa më të plotë të modeleve të lejueshme të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një fjale, duke u mbështetur në punën e sintaksologëve paraardhës dhe b) të paraqesë përfundime nga një studim pilot¹ mbi gjendjen ekzistuese të këtyre modeleve në shqipen e folur sot, çështje e cila nuk ka tërhequr sa duhet vëmendjen e studiuesve të gjuhës shqipe. Studimi i gjuhës së folur, përkarshi gjuhës së shkruar, është kërkesë themelore e gjuhësisë moderne (Palmer, 1983: 27; Radford, 1992: 8). Qëllimi i gjuhësisë së sotme është përshkrimi i kompetencës gramatikore abstrakte të folësit dhe për këtë qëllim gjuha e folur është një fushë studimi më pjellore dhe më rezultative se gjuha e shkruar (Radford, 1992: 9).

2. Përmbledhje e studimeve të kryera mbi rendin e përcaktorëve të njëpasnjëshëm

Së pari, është me vlerë të veçantë që të shqyrtojmë arritjet e deritanishme në lidhje me këtë çështje. Albanologët që janë marrë me këtë çështje janë të paktë, si: M. Totoni, Th. Rushi, Sh. Demiraj, dhe K. Topalli. Mendimet e Sh. Demiraj në *Gramatikë Historike e Gjuhës Shqipe (1985)* nuk do të paraqiten në këtë përmbledhje, pasi ai përqendrohet kryesisht në faktorët që përcaktojnë para ose prapavendosjen e përcaktorëve të një emri në shqipe dhe në gjuhë të tjera i.e., gjë që nuk përbën objektin e këtij studimi.

¹ Një studim pilot është një studim i përmasave relativisht të vogla që i paraprin një studimi masiv për një çështje të caktuar. Qëllimi i studimit pilot është të vërtetojë nëse metodologjia dhe materiali kërkimor i përdorur janë të përshtatshëm për të studiuar një dukuri të caktuar përpara se të kalohet në vjelje masive që kërkojnë kohë dhe burime të shumta njerëzore dhe materiale (Woods, Fletcher & Hughs, 1986).

Menella Totoni (1981) parashton disa modele renditjeje normative të shqipes dhe disa të tjera që nuk janë në pajtim me normën dhe që duhen shmangur. Më poshtë do të shohim modelet e përshkruara nga ky studiues, të shoqëruara me shembuj të nxjerrë nga i njëjti artikull i tij.

Modeli 1: emër + përemër + përcaktor tjetër

fytyrën e tij me prenka

partinë tonë të madhe

Modeli 2: emër + përcaktor tjetër + përemër i emërzuar

e drejtë e ligjshme jona

Modeli 3: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm

ngjarjet e mëdha popullore

Modeli 4: emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër i nyjshëm

kungull ujës i madh (tog i ngurosur)

gjel deti i majmë (tog i ngurosur)

Modeli 5: emër + mbiemër + emër

kundërmimi i vakët i pranverës

Modeli 6: emër + emër me parafjalë + emër në gjinore

shtëpiza prej trarësh e Leskave

Modeli 7: emër foljor + emër në gjinore + emër me parafjalë

marrja e vendit me armë

Modeli 8: emër foljor + përemër + emër me parafjalë

hyrjen e tij në mulli

Ndërkohë, Totoni (1981) thekson që modelet e mëposhtme janë ose në kundërshtim me normën gjuhësore (modelet 1, 4, 5), ose sjellin agramatikalitet (modeli 2), ose duhen mënjanuar për shkak të dykuptimisë (modeli 3):

Modeli 1: emër + emër + mbiemër

valë gëzimi e papritur

vëllimit të punës të nevojshëm

Modeli 2: emër + emër në gjinore + emër me parafjalë

shtëpiza e Leskave prej trarësh

Modeli 3: emër + emër parafjalë + emër në gjinore²

aeroplanët prej letre të Pacit

Modeli 4: emër foljor + emër me parafjalë + emër në gjinore

marrja me armë e vendit

Modeli 5: emër foljor + emër me parafjalë + përemër

hyrjen në mulli e tij

Në vijim të kësaj pune, Totoni (1983:72) formulon dy rregulla të përgjithshme për sa i përket rendit dhe trajtës së gjymtyrëve plotësuese, të cilat nënkuptojnë

² Vini re se si ky model trajtohet edhe si i lejueshëm nga Totoni në rastin e *shtëpiza prej trarësh e Leskave*.

që autori mendon se vetëm modelet e mëposhtme, të shoqëruara me shembujt e tij, janë normative:

Modeli 1: emër jofoljor + emër me parafjalë që shpreh një karakteristikë cilësore + emër në gjinore
trualli me kashtë i kolibes

Modeli 2: emër foljor + emër me parafjalë si rrethanor + emër në gjinore

pasqyrimi në kosto i këtij treguesi

Modeli 3: emër foljor + emër në gjinore+ emër me parafjalë si rrethanor

pasqyrimi i këtij treguesi në kosto

Modeli 4: emër foljor + emër me parafjalë si kundrinor + emër në gjinore

sanksionimi i parimeve në kushtetutë

Modeli 5: emër foljor + emër në gjinore+ emër me parafjalë si kundrinor

sanksionimi në kushtetutë i parimeve

Duke u mbështetur në punën e paraardhësve, Thoma Rushi (1983) paraqet gjithsej 15 modele të rendit të dy përcaktorëve të një emri, duke e detajuar më tej paradigmen e këtij rendi. Më poshtë veçojmë modelet e reja që përshkruan dhe u shton ky autor studimeve paraardhëse, duke i shoqëruar me shembujt e tij:

Modeli 1: emër + emër në rrjedhore + emër në gjinore
mënyrë të argumentuari të avokatit

Modeli 2: emër + emër në rrjedhore + emër me parafjalë
lugë druri me dy cungje

Modeli 3: emër + ndajfolje + emër
mënjanimi vetvetiu i fesë

Modeli 4: emër + emër + trajtë e pashtjelluar
mosgjetja e një mënyre komode për t'iu drejtuar

Studiuesi Kolec Topalli ka shkruar gjithashtu për rendin e përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një fjale. Topalli mendon se krijimi i nyjave të përparme, të cilat janë të lidhura ngushtë me emrin paraprirës, ka ndikuar në përcaktimin e kësaj topike. Kështu, kur emri ndiqet nga dy përcaktorë të shprehur me mbiemra, përkatësisht njëri i nyjshëm dhe tjetri i panyjshëm, mbiemri i nyjshëm vihet përpara dhe pastaj ai i panyjshëm, p.sh. *ditë e bukur pranverore* (Topalli, 2011: 1232).

Autori e shpjegon këtë me lidhjen e ngushtë që krijon mjeti lidhës (nyja e përparme) midis emrit dhe mbiemrit, lidhje që në rastin e përcaktorit të shprehur me mbiemër të panyjshëm është më e dobët për shkak të mungesës së mjetit lidhës. Kjo rregull vlen edhe kur, nga dy përcaktorët, mbiemri i

panyjshëm është më i lidhur logjikisht me emrin sesa ai i nyjshmi. P.sh. *lufta e parë botërore*, logjikisht duhet *lufta botërore e parë* (Topalli, 2011: 1232).

Rregulla nuk respektohet në rastin e përcaktorit të panyjshëm të shprehur me përemër, ku përemri pronor vjen i pari, ndërsa mbiemri i nyjshëm del në pozicion të dytë, p.sh. *vajza ime e madhe* (Topalli, 2011: 1232). Këtë dukuri studiuesi K. Topalli e lidh me sintagmat *emër i trajtës së shquar + përemër* ku janë formuar përemrat pronorë, rend që respektohet edhe kur sintagma ka përcaktorë të tjerë.

Autori mendon se lidhja *emër + përemër pronor* është më e fortë se lidhja *emër + mbiemër i nyjshëm*. Mbiemri i nyjshëm mund të dalë para pronorit vetëm në rastin kur ky i fundit është i emëruar. Pra, ka shprehur lidhjet sintaksore me emrin, p.sh. *me vëllanë e madh tëndin, vashza vogil jotja* (Topalli, 2011: 1233). E njëjta dukuri ndodh edhe me përemrin e pacaktuar *tjetër*, i cili në sintagmat *emër + përemër + mbiemër i nyjshëm* vjen menjëherë i pari pas përemrit, duke e lënë mbiemrin e nyjshëm në pozicion të dytë, më larg fjalës së pacaktuar, p.sh. *vajza tjetër e martuar* (Topalli, 2011: 1232). Pra, edhe një herë, përemri është më i lidhur me emrin që përcakton sesa mbiemri i nyjshëm që përcakton të njëjtin emër.

Pronorët e nyjshëm ndjekin të njëjtën rregull, por për këta rregullat ndryshojnë sipas vetave (Topalli, 2011: 1232). Përemrat pronorë të vetës III nuk vendosen detyrimisht menjëherë pas emrit të pacaktuar, p.sh. *vajza e saj e madhe* dhe *vajza e madhe e saj*. Çlirësinë e kësaj rregulle autori e shpjegon me atë që përemrat pronorë të vetës III interpretohen herë si pronorë dhe herë si dëftorë. Në shembullin e dytë pronori i vetës III përputhet me përemrin dëftor të rasës gjinore.

Atëherë, gjedhet e renditjes që përshkruan Prof. Topalli në veprën e vet janë të mëposhtmet:

Modeli 1: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm
ditë e bukur pranverore

Modeli 2: emër + përemër pronor i panyjshëm + mbiemër i nyjshëm
vajza ime e madhe

Modeli 3: emër + mbiemër i nyjshëm + përemër i emëruar
me vëllanë e madh tëndin

Modeli 4: emër + përemër i pacaktuar + mbiemër i nyjshëm
vajza tjetër e martuar

Modeli 5: emër + përemër pronor i nyjshëm veta I/II + mbiemër i nyjshëm

petkat e mia të reja

Modeli 6: emër + përemër pronor i nyjshëm veta III + mbiemër i nyjshëm

vajza e saj e madhe

III Modeli 7: emër + mbiemër i nyjshëm + përemër pronor i nyjshëm veta
vajza e madhe e saj

4. Paradigma e rendit të përcaktorëve të njëpasnjëshëm

Mbështetur në punën e studiuesve³ të mësipërm dhe në gramatikat e shqipes, na rezulton që paradigma e rendit të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm përmban 20 modele përfaqësuese. Kjo paradigmë është e paraqitur më poshtë herë-herë me shembuj të marrë nga studiuesit e lartpërmendur dhe herë-herë me shembuj të gjendur në bazë të gjedheve të njohura të shqipes:

- Modeli 1: emër + përemër + mbiemër i nyjshëm
dora e saj e ngrohtë
- Modeli 2: emër + përemër + mbiemër i panyjshëm
dora e saj bardhoshe
- Modeli 3: emër + përemër + mbiemër prejpjesor
dora e saj e rrudhur
- Modeli 4: emër + përemër + emër me parafjalë
dora e tij me qime
- Modeli 5: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm
vajza e vogël lozonjare
- Modeli 6: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër prejpjesor
vajza e vogël e dobësuar
- Modeli 7: emër + mbiemër i nyjshëm + emër në gjinore
vajza e vogël e Klarës
- Modeli 8: emër + mbiemër i nyjshëm + emër me parafjalë
vajza e vogël me fustan
- Modeli 9: emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër prejpjesor
arti letrar i kulluar
- Modeli 10: emër + mbiemër i panyjshëm + emër në gjinore
arti letrar i Rilindjes
- Modeli 11: emër + mbiemër i panyjshëm + emër me parafjalë
arti letrar me risi
- Modeli 12: emër + mbiemër prejpjesor + emër në gjinore
trupi i nxirë i djalit
- Modeli 13: emër + mbiemër prejpjesor + emër me parafjalë
trup i nxirë me muskuj
- Modeli 14: emër + emër në gjinore + emër në gjinore

³ Me përcaktorin janë marrë edhe studiuesit S. Prifti (1977) dhe A. Dhrimo (1969), por objekti i studimit të tyre nuk ka qenë posaçërisht rendi i dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një emri.

- dhoma e gjumit e mamasë
- Modeli 15: emër + emër në rrjedhore + emër në gjinore
shenjë serioziteti e kryetarit
- Modeli 16: emër + emër në rrjedhore + emër me parafjalë
shembull virtytësh për pasardhësit
- Modeli 17: emër + ndajfolje + emër në gjinore
futja vetvetiu e fesë
- Modeli 18: emër + emër në gjinore + emër me parafjalë
profesor i gjuhësisë me xhepa të shpuar
- Modeli 19: emër + emër me parafjalë + emër në gjinore
fitore me gjak e shqiptarëve
- Modeli 20: emër + emër në gjinore + infinitiv
dëshira e nxënësve për të lexuar

5. Studimi pilot dhe metodologjia e tij

Siç u theksua më lart, modelet e rendit të përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një emri janë hartuar kryesisht duke u mbështetur në vjelje të bëra nga letërsia e shkruar. Gjendja aktuale e këtyre modeleve në shqipen e folur nuk ka tërhequr sa duhet vëmendjen e studiuesve të gjuhës shqipe, zbrazëti e cila duhet plotësuar edhe në studimin e dukurive të tjera gjuhësore. Studime të tilla të gjuhës së folur përkarshi gjuhës së shkruar janë me vlerë të madhe për të kuptuar më mirë tiparet karakteristike të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe në gjendjen e sotme dhe për ta dokumentuar këtë gjendje, që në të ardhmen do të ketë vlerë për studime historike. Këto vjelje vlejné për të studiuar më mirë edhe dukuri morfosintaksore (Demiraj, 1985: 530). Por këto dukuri nuk mund t'i trajtojmë këtu, sepse kjo do të na largonte nga tema kryesore e këtij studimi.

Ky studim pilot mori në shqyrtim paradigmen e mësipërme të rendit të përcaktorëve të njëpasnjëshëm në gjuhën e folur. Metodologjia e përdorur është *Gjykimi mbi Gramatikalitetin (Grammaticality Judgment Task)*, e cila është një nga metodat kërkimore gjuhësore më të përdorura në gjuhësinë bashkëkohore (Schutze, 1996). Sipas kësaj metode, folësve të gjuhës u jepen të dhëna gjuhësore ndaj të cilave ata duhet të shprehin reagimin e tyre duke përcaktuar nëse këto të dhëna u tingëllojnë mirë në gjuhën e tyre amtare. Pjesëmarrësit në studimin tonë ishin 10 folës të rritur të shqipes amtare, gegë dhe toskë, pa çrregullime të njohura konjitive dhe gjuhësore. Të gjithë pjesëmarrësit ishin pa përjashtim njohës dhe përdorues të mirë të standardit, por iu kërkua që të përgjigjeshin nëse togjet u tingëllonin shqip, pavarësisht nga njohuritë që kishin për standardin. Konkretisht, detyra kërkonte që këta

folës të gjykonin nëse rendi normativ dhe ai i anasjelltë⁴ i dy përcaktorëve në 20 modelet e paradigmës së lartpërmendur u tingëllonte mirë në shqip. Pjesëmarrësve iu dha vetëm kërkesa e mëposhtme: “Tani do të dëgjosh disa togje fjalësh. Të lutem, më thuaj nëse të tingëllojnë shqip.”

Rendi i anasjelltë i përcaktorëve të modeleve të sugjeruara si normative nga autorët që morëm në shqyrtim më lart, erdhi si pasojë e raportimeve konfliktuale shkencore për rende të caktuara jo vetëm brendapërbrenda punës së një autori (shih p.sh. Totoni), por edhe nga njëri autor te tjetri (shih p.sh. Totoni vs. Rushi). Gjithashtu, intuita jonë gjuhësore si folëse amtare të shqipes na tregon që gjuha e folur lejon disa rende të anasjella të rendeve normative. Me fjalë të tjera, pyetja shkencore është: “Sa i ngulitur është rendi i dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm në shqip?” Mënyra më e mirë për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje është të lësh folësin amtar të gjykojë nëse rendi normativ dhe njëkohësisht edhe ndërrimi i pozicioneve të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një emri është i natyrshëm për të. Për këtë arsye, pjesëmarrësit dëgjuan shembujt e rendit normativ dhe atij të anasjelltë të dy përcaktorëve të një emri dhe iu kërkuar të gjykonin nëse u tingëllonin shqip. Më poshtë gjendet vetëm rendi i anasjelltë, meqenëse rendi normativ është dhënë në sythin 4. Rendi i anasjelltë është paraqitur në tekst me anë të indeksimit 1a, 2a, 3a, 4a, etj.

Modeli 1a: emër + përemër + mbiemër i nyjshëm

dora e ngrohtë e saj

Modeli 2a: emër + përemër + mbiemër i panyjshëm

dora bardhoshe e saj

Modeli 3a: emër + përemër + mbiemër prejpjesor

dora e rrudhur e saj

Modeli 4a: emër + përemër + emër me parafjalë

dora me qime e tij

Modeli 5a: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm

vajza lozonjare e vogël

Modeli 6a: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër prejpjesor

vajza e dobësuar e vogël

Modeli 7a: emër + mbiemër i nyjshëm + emër në gjinore

vajza e Klarës e vogël

Modeli 8a: emër + mbiemër i nyjshëm + emër me parafjalë

vajza me fustan e vogël

Modeli 9a: emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër prejpjesor

arti i kulluar letrar

⁴ Rendi i anasjelltë është paraqitur në tekst me anë të indeksimit 1a, 2a, 3a, 4a, etj.

- Modeli 10a: emër + mbiemër i panyjshëm + emër në gjinore
arti i Rilindjes letrar
- Modeli 11a: emër + mbiemër i panyjshëm + emër me parafjalë
arti me risi letrar
- Modeli 12a: emër + mbiemër prejppjesor + emër në gjinore
trup i djalit i nxirë
- Modeli 13a: emër + mbiemër prejppjesor + emër me parafjalë
trup me muskuj i nxirë
- Modeli 14a: emër + emër në gjinore + emër në gjinore
dhoma e mamasë e gjumit
- Modeli 15a: Emër + emër në rrjedhore + emër në gjinore
shenjë e kryetarit serioziteti
- Modeli 16a: emër + emër në rrjedhore + emër me parafjalë
tavolinë për fëmijët druri
- Modeli 17a: emër + ndajfolje + emër në gjinore
futja e fesë natyrshëm
- Modeli 18a: emër + emër në gjinore + emër me parafjalë
profesor me xhepa të shpuar i gjuhësisë
- Modeli 19a: emër + emër me parafjalë + emër në gjinore
fitore e shqiptarëve me gjak
- Modeli 20a: emër + emër në gjinore + formë e pashtjelluar
dëshira për të lexuar e nxënësve

6. Diskutime dhe përfundime

Rezultatet e studimit të kryer tregojnë që folësit respektojnë rendin e përshkruar në standard si normativ vetëm në 35% të modeleve të rendit të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një emri. Modelet të cilat pranohen të ngulitura si në standard, ashtu edhe në gjuhën e folur, janë 7 modelet e mëposhtme.

- Modeli 6: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër prejppjesor
vajza e vogël e dobësuar
- Modeli 7: emër + mbiemër i nyjshëm + emër në gjinore
vajza e vogël e Klarës
- Modeli 8: emër + mbiemër i nyjshëm + emër me parafjalë
vajza e vogël me fustan
- Modeli 10: emër + mbiemër i panyjshëm + emër në gjinore
arti letrar i Rilindjes
- Modeli 11: emër + mbiemër i panyjshëm + emër me parafjalë
arti letrar me risi
- Modeli 15: emër + emër në rrjedhore + emër në gjinore

shenjë serioziteti e kryetarit

Modeli 16: emër + emër në rrjedhore + emër me parafjalë
shembull virtytësh për pasardhësit

Pra, rendi i anasjelltë i tyre, i paraqitur në modelet më poshtë, nuk u pranua në gjuhën e folur:

Modeli 6a: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër prejpjesor
vajza e dobësuar e vogël

Modeli 7a: emër + mbiemër i nyjshëm + emër në gjinore
vajza e Klarës e vogël

Modeli 8a: emër + mbiemër i nyjshëm + emër me parafjalë
vajza me fustan e vogël

Modeli 10a: emër + mbiemër i panyjshëm + emër në gjinore
arti i Rilindjes letrar

Modeli 11a: emër + mbiemër i panyjshëm + emër me parafjalë
arti me risi letrar

Modeli 15a: Emër + emër në rrjedhore + emër në gjinore
shenjë e kryetarit serioziteti

Modeli 16a: emër + emër në rrjedhore + emër me parafjalë
tavolinë për fëmijët druri

Ndërsa modelet të cilat u pranuan si në rendin e sugjeruar nga standardi, edhe në rendin e anasjelltë, janë 13 modelet e mëposhtme. Këto modele përbëjnë 65% të paradigmës së paraqitur më lart.

Modelet normative të pranuar nga folësit

Modeli 1: emër + përemër + mbiemër i nyjshëm
dora e saj e ngrohtë

Modeli 2: emër + përemër + mbiemër i panyjshëm
dora e saj bardhoshe

Modeli 3: emër + përemër + mbiemër prejpjesor
dora e saj e rrudhur

Modeli 4: emër + përemër + emër me parafjalë
dora e tij me qime

Modeli 5: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm
vajza e vogël lozonjare

Modeli 9: emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër prejpjesor
arti letrar i kulluar

Modeli 12: emër + mbiemër prejpjesor + emër në gjinore
trupi i nxirë i djalit

Modeli 13: emër + mbiemër prejpjesor + emër me parafjalë
trup i nxirë me muskuj

Modeli 14: emër + emër në gjinore + emër në gjinore
dhoma e gjumit e mamasë

- Modeli 17: emër + ndajfolje + emër në gjinore
futja natyrshëm e fesë
- Modeli 18: emër + emër në gjinore + emër me parafjalë
profesor i gjuhësisë me xhepa të shpuar
- Modeli 19: emër + emër me parafjalë + emër në gjinore
fitore me gjak e shqiptarëve
- Modeli 20: emër + emër në gjinore + formë e pashtjelluar
dëshira e nxënësve për të lexuar

Modelet e anasjella të pranuar nga folësit

- Modeli 1a: emër + përemër + mbiemër i nyjshëm
dora e ngrohtë e saj
- Modeli 2a: emër + përemër + mbiemër i panyjshëm
dora bardhoshe e saj
- Modeli 3a: emër + përemër + mbiemër prejpjesor
dora e rrudhur e saj
- Modeli 4a: emër + përemër + emër me parafjalë
dora me qime e tij
- Modeli 5a: emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm
vajza lozonjare e vogël edhe pranohet
- Modeli 9a: emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër prejpjesor
arti i kulluar letrar
- Modeli 12a: emër + mbiemër prejpjesor + emër në gjinore
trupi i djalit i nxirë
- Modeli 13a: emër + mbiemër prejpjesor + emër me parafjalë
trup me muskuj i nxirë
- Modeli 14a: emër + emër në gjinore + emër në gjinore
dhoma e mamasë e gjumit
- Modeli 17a: emër + ndajfolje + emër në gjinore
futja e fesë natyrshëm
- Modeli 18a: emër + emër në gjinore + emër me parafjalë
profesor me xhepa të shpuar i gjuhësisë
- Modeli 19a: emër + emër me parafjalë + emër në gjinore
fitore e shqiptarëve me gjak
- Modeli 20a: emër + emër në gjinore + formë e pashtjelluar
dëshira për të lexuar e nxënësve

Megjithëse këto rezultate vijnë nga një studim i një shkalle të vogël, vlen të theksohen dy përfundime të rëndësishme. Së pari, duhet vënë në dukje që gjendja reale e rendit të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm në shqip mund të mos jetë domosdoshmërisht gjendja që përshkruhet në normë nga gjuhëtarët. Ky përfundim nxjerr në pah nevojën e ngutshme të kryerjes së një studimi të

përmasave më të gjera për të parë më konkretisht gjendjen e shqipes për sa i përket kësaj dukurie sintaksore (por edhe dukurive të tjera). Së dyti, kjo shtron nevojën e përditësimit të sintaksës së gjuhës shqipe, mbështetur në vjelje të bëra nga gjuha e folur dhe e shkruar, jo vetëm për sa i përket përshkrimit të rendit të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një emri, por edhe në lidhje me interpretimin teorik të këtij rendi të ngurtë ose të lirshëm.

Më poshtë do të mundohemi të japim një shpjegim të pangarkuar teorikisht për rendin e ndërkëmbyeshëm të dy përcaktorëve të një emri. Për sa i përket rendit *emër + përemër + mbiemër i nyjshëm* (dora e saj e ngrohtë), fakti që folësit pranojnë edhe rendin e anasjellë *emër + mbiemër i nyjshëm + përemër* kur ky i fundit është i nyjshëm, përkon me mendimin e gjuhëtarit K. Topalli për interpretim jo të njëjtë të rendit të mësipërm kur përemri është i panyjshëm dhe kur është i nyjshëm.

Po kështu, të dhënat e marra nga folësit mbështesin mendimin e tij për rend të lirshëm të përcaktorëve në rastin kur njëri prej tyre është i shprehur me përemër të nyjshëm të vetës III dhe tjetri shprehet me një mbiemër të nyjshëm. Pra, përemrat pronorë të vetës III interpretohen herë si pronorë (dora e saj e ngrohtë) dhe herë si dëftorë të rasës gjinore (dora e ngrohtë e saj). Ky interpretim mund të vlejë edhe për modelin 2: *emër + përemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm* (dora e saj bardhoshe), modelin 3: *emër + përemër i nyjshëm + mbiemër prejpjesor* (dora e saj e rrudhur), modelin 4: *emër + përemër i nyjshëm + emër me parafjalë* (dora e tij me qime), për të cilat folësit pranuan edhe rendin e anasjellë si rend të pranueshëm.

Në rastin e modelit 5: *emër + mbiemër i nyjshëm + mbiemër i panyjshëm* (vajza e vogël lozonjare), pritej që folësit të përdornin vetëm këtë rend dhe jo edhe rendin e anasjellë, mbështetur në interpretimet e gjuhëtarëve shqiptarë për lidhjen e ngushtë sintaksore që krijon nyja me emrin paraprijës. Me sa duket, kjo lidhje sintaksore e nyjës me emrin të cilit i referohet, ruhet kaq mirë edhe në distancë, saqë mund të lejojë dhe futjen e një përbërësi tjetër sintaksor midis përcaktorit të shprehur me mbiemër të nyjshëm dhe emrit të përcaktuar prej tij (vajza lozonjare e vogël).

Në modelin 9: *emër + mbiemër i panyjshëm + mbiemër prejpjesor* (arti letrar i kulluar), përdorimi edhe i rendit të anasjellë të përcaktorëve, sipas modelit 9a, tregon që togu *art letrar* herë interpretohet nga folësit si i ngurtë e herë si tog i lirë. I njëjti shpjegim vlen edhe për modelin 14: *emër + emër në gjinore + emër në gjinore* (dhoma e gjumit e mamasë). Lirshmëria e ndërkëmbimit të rendit të dy përcaktorëve, si në modelin 14a, na bën të mendojmë që togu *dhoma e gjumit* nuk është ngurtësuar plotësisht akoma.

Në modelin 12: *emër + mbiemër prejpjesor + emër në gjinore* (trup i nxiirë i djalit), shihet se folësit herë e interpretojnë mbiemrin prejpjesor të nyjshëm si çdo mbiemër tjetër të nyjshëm, duke e mbivendosur kështu me

modelin 7: *emër + mbiemër i nyjshëm + emër në gjinore* (vajza e vogël e Klarës), e herë si mbiemër prejppjesor, dmth. me predikativitet, dhe si të tillë me lidhje sintaksore më të lirshme me emrin që përcakton. Interpretimi ambig i mbiemrit prejppjesor prej folësve shpjegon edhe lirshmërinë e rendit të përcaktorëve në modelin 13: *emër + mbiemër prejppjesor + emër me parafjalë* (trup i nxirë me muskuj). Edhe në këtë rast mbiemri prejppjesor mund të lexohet prej folësve amtarë: a) si mbiemër i nyjshëm në modelin 13 dhe b) si mbiemër me predikativitet në modelin 13a.

Përdorimi i ndajfoljes para ose pas emrit në gjinore në modeli 17: *emër + ndajfolje + emër në gjinore* (futja natyrshëm e fesë) mund të shpjegohet me atë që emri në gjinore e ruan qartë lidhjen semantiko-sintaksore me emrin që përcakton si në pozicionin menjëherë pas emrit të përcaktuar, edhe në pozicion të dytë në lidhje me emrin e përcaktuar, dmth. i ndarë nga një përbërës tjetër si në rastin e modeleve 18: *emër + emër në gjinore + emër me parafjalë* (profesor i gjuhësisë me xhepa të shpuar),

19: *emër + emër me parafjalë + emër në gjinore* (fitore me gjak e shqiptarëve) dhe 20: *emër + emër në gjinore + formë e pashtjelluar* (dëshira e nxënësve për të lexuar)⁵.

Si përfundim, ky studim hodhi dritë në dy drejtime të rëndësishme: a) paraqiti një paradigmë sa më të plotë të modeleve të lejueshme në standard të dy përcaktorëve të njëpasnjëshëm të një fjale, duke u mbështetur në punën e sintaksologëve paraardhës dhe b) prezantoi përfundimet e para të llojit të vet mbi gjendjen ekzistuese të këtyre modeleve në shqipen e folur sot, çështje e cila duhet të tërheqë vëmendjen e studiuesve të gjuhës shqipe për përditësimin e sintaksës së gjuhës shqipe në aspektin përshkrimor dhe analitik.

Bibliografi

Çeliku, M., Domi, M., Floqi, F., Mansaku, S. Përnaska, R., Prifti, S., Totoni, M. (1997). *Gramatikë e Gjuhës Shqipe II*. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Tiranë.

Demiraj, Sh. (1986). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Shtypshkronja "Mihal Duri". Tiranë.

Dhrimo, A. (1969). *Vëzhgime rreth ngulitjes së normës gjuhësore në publicistikën e pasçlirimit*. Studime Filologjike. Nr. 3.

Palmer, F. R. (1983). *Grammar*. Penguin, London.

Prifti, S. (1977). *Përcaktori në gjuhën shqipe*. Studime Filologjike. Nr. 1, f. 33-59.

⁵ Përbërësit që dalin si para, edhe pas një përcaktori që zgjeron emrin kryejnë të njëjtin funksion sintaksor, atë të adjunktit, por kjo çështje do të jetë objekt i një studimi të veçantë, prandaj nuk do të hulumtohet posaçërisht në këtë artikull.

Radford, A. (1992). *Transformational Grammar*. Cambridge University Press, Cambridge.

Rushi, Th. (1983). *Rendi i dy përcaktorëve të një gjymtyre*. Gjuha jonë. Nr. 3, f. 46-53.

Schütze, C. (1996). *The experimental base of linguistics: Grammaticality Judgments and linguistic methodology*. Chicago: University of Chicago Press.

Topalli, K. (2011). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Qendra e Studimeve Albanologjike. Tiranë.

Totoni, M. (1981). *Rendi i përcaktorëve të një gjymtyre*. Mësuesi. Qershor, 10.

Totoni, M. (1983). *Rreth rendit dhe trajtës së gjymtyrëve plotësuese*. Gjuha jonë. Nr. 2.

Woods, A., Fletcher, P. & Arthur Hughs. (1986). *Statistics in Language Studies*. Cambridge University Press, Cambridge.

SUMMARY

ORDERING OF POSTNOMINAL PHRASES IN MODERN ALBANIAN

This article looks at the ordering of postnominal phrases in modern spoken Albanian through a pilot study. The participants were 10 adults (gheg and tosk) which were tested through a Grammaticality Judgment Task by using an ordering paradigm of postnominal phrases in Albanian, which has first been brought forth as a complete representational paradigm in this work. This paradigm consists of all the ordering models of postnominal phrases that have been suggested for standard Albanian by previous literature. The results of this experimental work were twofold. First, it was found that speakers differ in their ordering of postnominal phrases in that they only use the exact ordering as in standard Albanian by only 35 % of all the cases (models). Second, this study calls for greater attention to the investigation of spoken language as a crucial component, alongside written language, in understanding not just speakers' linguistic competence, but also in revising and updating our knowledge of Albanian syntax.

